



BORDI

VENDIM

Nr.130, Datë 29.08.2019

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E APLIKIMIT TË SHOQËRISË
“AYEN AS ENERGJI” SH.A., PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT
TË ENERGJISË ELEKTRIKE, PËR NJË AFAT 5 (PESË) VJEÇAR.**

Në mbështetje të nenit 16, nenit 37, pika 2 gërma “d” të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar, nenit 4, pika 1, gërma “e”; nenit 5, pika 1 gërma “e”; nenit 10, pikat 1 dhe nenit 3 të “Rregullores për Procedurat dhe Afatet për Dhënie, Modifikimin, Transferimin, Rinovimin ose Heqjen e Licencave në Sektorin e Energjisë Elektrike”, të miratuar me Vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016, si dhe nenit 19 pika 1 gërma “a” të “Rregullores së Organizimit, Funkcionimit dhe Procedurave të ERE-s”, miratuar me Vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 29.08.2019, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “AYEN AS ENERGJI” sh.a., si dhe relacionin me nr.79/8 datë 26.08.2019 të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikqyrjes për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “AYEN AS ENREGJI” sh.a., për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, të kësaj shoqërie,

Konstatohet se:

- Shoqëria “AYEN AS ENERGJI” sh.a., ka aplikuar në ERE për t’u pajisur me licencë në veprimtarinë e Tregtimit të Energjisë Elektrike, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 514/2 Prot, datë 22 .08.2019.
- Shoqëria “AYEN AS ENERGJI” sh.a., zotëron licencën për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike me nr.241, seria T14, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s, nr.79, datë 09.09.2014, për një periudhë 5 vjeçare, periudhë e cila përfundon në datën 09.09.2019.
- Aplikimi i shoqërisë “AYEN AS ENERGJI” sh.a., plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për Procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e Energjisë Elektrike” si më poshtë:
 - Formati i aplikimit (neni 9, pika 1, gërmat “a” “b”, “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte;
 - Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2 gërmat “a”, “b”, “c”, “d” dhe “e”) është plotësuar në mënyrë korrekte;

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3 gërmat “b”, “c” dhe “d”) është plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni teknik për aktivitetin tregtimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4.8 gërmat “a”, “b”, “c” dhe “d”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Në lidhje me azhurnimin e dokumentacionit që ka të bëjë me:

- *Formati dhe dokumentacioni për aplikim, neni 9, pika 1, gërma “a” (prokura e përfaqësimit të të deleguarit), si kërkesë e nenit 7, pika 2 të “Rregullores për Procedurat dhe Afatet për Dhënien, Modifikimin, Transferimin, Rinovimin ose Heqjen e Licencave në Sektorin e Energjisë Elektrike”.*
- *Dokumentacioni financiar dhe fiskal, neni 9, pika 3, gërma “a” (Vërtetim për shlyerjen e tatim-taksave dhe Vërtetim për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore), paraqitur jo në përputhje me kërkesat e nenit 8, pika 3 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e Energjisë Elektrike”.*

Do të njoftohet subjekti që në bazë të Rregullores sipërcituar, neni 10, pika 9 dhe neni 11, pika 1, t’i paraqesë këto në ERE, brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë e procedurën për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “AYEN AS ENERGJI” sh.a., për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5 (pesë) vjeçar.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brënda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare

KRYETAR

Petrit AHMETI